

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Krimeve të Renda (në Objektivin e gjykatës në Vushtri) Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Lale Miftari, në çështjen penale kundër të pandehurve; [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të akuzuar për veprën penale: Dhënia e ryshfetit sipas nenit 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.199/ 2016, dt:17.05.2017 dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në të njëjtën aktakuzë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzë dhe propozimit në të, jashtë shqyrtimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale, me 28.06.2017, nxjerrë këtë

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.I.nr.199/2016, dt:17.05.2017, dhe kjo Gjykata lëshon këtë:

URDHËR - NDËSHKIMOR

Kundër të akuzuarve:

1. [REDAKTUAR], i njohur me nofkën "[REDAKTUAR]" nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] mbiemri i vajzërisë se nenës [REDAKTUAR] i lindur me 02.09.1971 ne fsh. [REDAKTUAR] me vendbanim ne rr. "[REDAKTUAR]" Mitrovicë-veri me numër personal te identifikimit: [REDAKTUAR] serb, shtetas i Republikës se Kosovës, i punësuar ne PTK në pozitën postier, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale.
2. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR], mbiemri i [REDAKTUAR] i lindur me 16.09.1978 ne Zubin Potok, me vendbanim ne fsh. [REDAKTUAR], me numër personal te identifikimit: [REDAKTUAR] serb, shtetas i Republikës se Kosovës, bujk, i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, ndaj tij zhvillohet procedurë për vepra tjera penale.

-I-

I akuzuari SLAVOLJUB DIMIC:

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Me 14.10.2016 rreth orës 20:21:50 sec në fsh.Nadakovc KK Vushtri, i pandehuri ne mënyrë të drejtpërdrejtë u ka dhënë ryshfet personave zyrtar – zyrtarëve policor Ahmet Hasani dhe Zeki Shala, nga Njesisë së Trafikut Regional në Mitrovicë-Jug, në mënyrë që personi zyrtar të mos veproj në pajtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që pasi që zyrtaret policor Ahmet Hasani dhe Zeki Shala e kanë ndaluar të pandehurin, i njëjti është ofruar të automjeti zyrtar i policisë i markës "Shkoda Rapid" me tabela të regjistrimit "POLICE 083-04" në të cilin automjet brenda ishte zyrtari policor Zeki Shala dhe duke i lutur qe të mos i shqiptojnë tiketën me gjobë, e në këmbim dy personave zyrtar –zyrtarëve policor ju jep ryshfet shumën e parëve prej; 10 euro, me qëllim që ata të mos ia shqiptojnë tiketën me gjobë për kundërvajtjen kryer në trafik. Pastaj, zyrtarët policor nuk i shqiptojnë dënimin për kundërvajtje të pandehurit por e lirojnë nga kjo kundërvajtje.

Me këtë ka kryer veprën penale: Dhënia e ryshfetit sipas nenit 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



II

I akuzuari GORAN DJURIC:

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Me 14.10.2016 rreth orës 20:21:50 sec në fsh.Nadakovc KK Vushtrri, i pandehuri në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka ofruar / i ka dhënë ryshfet personave zyrtar- zyrtarëve policor Ahmet Hasani dhe Zeki Shala nga Njësia e trafikut Regjional në Mitrovicë-Jug, në mënyrë që personi zyrtar të mos veproj ne pajtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që pasi që zyrtaret policor Ahmet dhe Zeki e kanë ndaluar të pandehurin i cili drejtonte kamionin e ngarkuar me dru në drejtim të Prishtinës, dhe nga kontrolli i policisë është konstatuar se i njëjti ka pas dritat e automjetit jo funksionale, dhe gjatë marrjes se shënimeve nga polici Ahmet, i njëjti ka dhënë dokumentacionin në emër të djalit të axhës Milentijes është ofruar te automjeti zyrtar i policisë i markës “Shkoda Rapid me tabela të regjistrimit POLICE 083-04” në të cilin automjet brenda ishte polici Zeki Shala kurse Ahmeti qëndronte në këmbë afër automjetit. I pandehuri [REDAKTUAR] duke i lutur që të mos i shqiptojnë dënim me gjobë për kundërvajtje u ofron shërbime duke u thënë “mund të ju sjellë dru apo diçka tjetër c’farë ata dëshirojnë” mirëpo pasi qe zyrtarët policor i tregojnë dënimin se sa mund të dënohen sipas ligjit për këtë parregullsi në këtë automjet, atëherë i njëjti iu ka ofruar dhe dhënë ryshfet zyrtareve policor Ahmet Hasanit dhe Zeki Shalës shumën prej 20 eurove, ku bankënotën prej 20 € e kishte vendosur në dokumentet të automjetit të cilat e pranon zyrtari policor Ahmet Hasani. Pastaj, zyrtarët policor nuk i shqiptojnë dënimin për kundërvajtje të pandehurit por e lirojnë tërësisht nga kjo kundërvajtje.

Me këtë ka kryer veprën penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në mbështetje të dispozitave, neneve 3, 8, 17, 21, 46, 73, dhe neni 429 par. 1 e lidhur te KPRK-se, dhe neneve 365, 493, 495, 496, të KPP-ës, të akuzuarve:

I. TË akuzuarit SLAVOLJUB DIMIC, I

SHQIPTON

- **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej / 500 / pesëqind / euro, të cilin dënim-gjobë, obligohet të paguaje në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, një dite burgim i llogaritet prej 20 € gjobë. Me pëlqim të personit të dënuar, dënimi me gjobë mund të zëvendësohet me dënim me urdhër për punë me dobi të përgjithshme, në përputhje me 46 par 5 të KPRK-së.
- **OBLIGOHET** i akuzuari [REDAKTUAR] që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën për 20 €, ndërsa për shpenzime të procedurës penale shumën prej 20 €. Të gjitha këto shpenzime duhet t’i paguajë ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati.



II. TË akuzuarit [REDAKTUAR] I

SHQIPTON

- **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej / 500 / pesëqind / euro, të cilin dënim-gjobë, obligohet të paguaje në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, një dite burgim i llogaritet prej 20 € gjobë. Me pëlqim të personit të dënuar, dënimi me gjobë mund të zëvendësohet me dënim me urdhër për punë me dobi të përgjithshme, në përputhje me 46 par 5 të KPRK-së.
- **OBLIGOHET** i akuzuari [REDAKTUAR] që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën për 20 €, ndërsa për shpenzime te procedurës penale shumën prej 20 €. Të gjitha këto shpenzime duhet t'i paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.199/2016, dt:17.05.2017, kundër të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për veprën penale: Dhënia e ryshfetit sipas nenit 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria, në aktakuzën e ngritur ka propozuar që ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të shqiptohet urdhri ndëshkimor-dënim me gjobë pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor në mbështetje të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Gjykata, rikujton se në akuzën e prokurorisë PP.I.nr.199/2016, përveç të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë të akuzuar edhe tridhjetepesë /35/ te pandehur tjerë zyrtar policor nga Njësia e Trafikut Mitrovicë Veri dhe Jug, për veprat penale: Marrja e ryshfetit sipas nenit 428 par 1 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se në këtë çështje penale ka kompetence lëndore, funksionale dhe territoriale për ta trajtuar këtë çështje sipas Ligjit mbi Gjykatat në Kosovë, si dhe në mbështetje të nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Me 28 qershor 2017, Gjykata ka nxjerrë aktvendim me të cilin ndaj të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e ka veçuar procedurën penale, ashtu që lënda penale ndaj tyre do të udhëhiqet me numër të ri të lëndes, në raport me lëndën paraprake dhe tani kjo lende mbanë numrin:P.nr.87/2017. Ndërsa, lënda ndaj të pandehurve tjerë të përfshirë në aktakuzën e prokurorisë PP.I.nr.199/2016 dt.17.05.2017, do të udhëhiqet me numër tjetër të lëndes dhe atë: P.nr.69/2017.

Gjykata, ka shqyrtuar aktakuzën, kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, provat dhe shkresat e lëndes dhe gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara, në përputhje me nenin 495 të KPP-se, dhe se janë plotësuar kushtet për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor.



Gjykata, gjen se në veprimet e të pandehurve [redacted] dhe [redacted] përmbushen elementet e veprës penale; Dhënia e ryshfetit sipas nenit 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo vërtetohet me këto prova: Nga incizimet e kamerave me audio dhe video-incizimi, incizime të siguruara me dt.14.10.2016, përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, të cilat janë siguruar sipas urdhrin të ligjshëm të kësaj Gjykate. Përgjegjësia penale e të pandehurve vërtetohet edhe me prova tjera, gjegjësisht nga mbrojtja që kanë paraqitur të pandehurit [redacted] dhe [redacted] në Inspektoratin Policor të Kosovës –Prishtinë me dt.18.01.2017 dhe me 20.01.2017, ku të pandehurit e pranojnë dhe pohojnë faktin se, kanë dhënë ryshfet personave zyrtar-zyrtarëve policor. Për Gjykatën të gjitha këto prova janë bindëse ku përtej çdo dyshimi vërtetohet se të pandehurit [redacted] dhe [redacted] kanë kryer veprën penale: Dhënia e ryshfetit sipas nenit 429 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu vërtetohet se aktakuza nuk përmbana asnjë shkelje ligjore apo faktike, nga gjitha këto arsye Gjykate vlerëson se janë përmbushur te gjitha kushtet ligjore për dhënin e urdhrin ndëshkimore pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, për të akuzuarit i vlerësoi rrethanat me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, mori për bazë gjendjen materiale dhe kushtet ekonomike te të akuzuarve, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë e veprës penale, motivin si dhe rrethanat tjera te përcaktuara me ligj. Nga këto arsye Gjykata, konsideron se dënimi i shqiptuar me gjobë në drejtim të të pandehurve si me larë do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurit dhe në raport me personat tjerë qe të përmbahen nga kryerja e veprave penale të natyrës se njëjtë, apo natyrave tjera.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësore gjykata e morri ne përputhje me nenin 450 te KPP.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Krimeve të Renda

P.nr.87/2017, i dt.28.06.2017

Procesmbajtësja:

Lale Miftari

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti



Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të parashtroj kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim te ketij aktgjykimi, kundërshtimi i derjtohet-dorezohet kesaj gjykate.